

LIGJ
Nr. 90/2012

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E ADMINISTRATËS SHTETËRORE
(Ndryshuar me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e veprimit

1. Qëllimi i këtij ligji është krijimi i një kuadri ligjor të njëjtë për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, më poshtë në tekstin e këtij ligji, “administrata shtetërore”, nëpërmjet përcaktimit të kriterëve për krijimin dhe funksionimin e institucioneve shtetërore.

2. Institucionet e arsimit të lartë publik, përfaqësitë diplomatike jashtë vendit, si dhe Forcat e Armatosura nuk janë pjesë e fushës së veprimit të këtij ligji.

Neni 2

Administrata shtetërore dhe funksionet e saj

1. Administrata shtetërore është aparati organizativ dhe profesional, që i shërben interesit publik me paanësi, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, duke kryer shërbimet publike dhe duke hartuar e zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore.

2. Funksioneve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni do t’i referohemi si “funksione administrative”.

3. Administrata shtetërore ka personalitet juridik publik dhe përbëhet nga struktura të organizuara në mënyrë hierarkike.

4. Kodi i Procedurës Administrative dhe ligjet sektoriale rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet personave privatë dhe administratës shtetërore në kryerjen e funksioneve administrative dhe vendimmarrjen mbi të drejtat dhe interesat e ligjshëm të këtyre personave.

Neni 3

Parimet e organizimit dhe funksionimit të administratës shtetërore

1. Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; dekoncentrimit; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësive; ekonomisë, efijencës dhe efektivitetit, si dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore.

2. Sipas parimit të unitetit dhe hierarkisë, administrata shtetërore organizohet në mënyrë të atillë që çdo organ, institucion apo njësi administrative, është në varësinë dhe i raporton një organi, institucioni apo njësie administrative, eprorë.

3. Sipas parimit të llogaridhënies, çdo organ, institucion apo njësi administrative i nënshtrohet drejtit dhe mbikëqyrjes nga organi epror përkatës, si për veprimtarinë e vet, ashtu edhe për atë të organeve, institucioneve apo njësive administrative vartëse.

4. Sipas parimit të dekoncentrimit, kryerja e funksioneve administrative, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me personat privatë, organizohet për t'u kryer sa më afër tyre, me qëllim lehtësimin e aksesit të tyre në informacion, në shërbimet publike, si dhe një pjesëmarrjeje të përshtatshme në procedimin administrativ, sipas ligjit.

5. Sipas parimit të qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësive, ndarja dhe caktimi i funksioneve dhe detyrave administrative, ndërmjet organeve, institucioneve dhe njësive administrative, duhet të jenë specifike, të shmangin mbivendosjen, të jenë transparente dhe të bëhen publike në mënyrë të përshtatshme.

6. Sipas parimit të ekonomisë, efijencës dhe efektivitetit, caktimi dhe shpërndarja e përgjegjësive, si dhe organizimi i administratës shtetërore duhet të sigurojnë efektivitetin në kryerjen e funksioneve dhe detyrave, efijencën në arritjen e objektivave të politikave të miratuara, si dhe ekonominë në përdorimin e të mirave dhe fondeve publike.

7. Sipas parimit të bashkëpunimit, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucioneve të pavarura, për arritjen e objektivave ligjorë që u janë besuar, në përputhje me ligjin.

KREU II

TIPOLOGJIA E ORGANIZIMIT TË ADMINISTRATËS SHETETËRORE

Neni 4

Organet dhe institucionet e administratës shtetërore

1. Kryeministri dhe ministrat janë organet e larta të administratës shtetërore. Ata drejtojnë dhe mbikëqyrin administratën shtetërore brenda fushës përkatëse të veprimtarisë shtetërore.

2. Administrata shtetërore përbëhet nga këto institucione:

a) Kryeministria;

b) ministritë;

c) institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave;

ç) njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve;

d) agjencitë autonome;

dh) administrata e prefektit.

3. Ministrinë dhe institucionet e varësisë mund të kenë degë territoriale në përputhje me këtë ligj.

4. Organizimi dhe funksionimi i Kryeministritë rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 5 **Ministritë**

(Ndryshuar pika 3, shfuqizuar fjalë në pikën 4 me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Çdo ministri drejtohet dhe përfaqësohet nga ministri, në vazhdim “ministri përgjegjës”. Ministri është përgjegjës përpara Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit për tërësinë e veprimtarisë së ministrisë, institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome, më poshtë “sistem ministror”, brenda fushës përkatëse të veprimtarisë shtetërore.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, përcakton fushën e veprimtarisë shtetërore në përgjegjësinë e çdo ministrie, në vazhdim “fusha e përgjegjësisë shtetërore”.

3. Ministria është përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore. Ministria kryen edhe të gjitha funksionet e tjera administrative brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, përveç atyre që u ngarkohen shprehimisht në aktin e krijimit apo akte të tjera ligjore e nënligjore institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome.

4. Ministria është, gjithashtu, përgjegjëse për koordinimin dhe për mbikëqyrjen e veprimtarisë së institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë ministrore.

5. Organizimi i ministrisë përfshin aparatin e ministrisë, si dhe degët e saj territoriale, nëse është rasti.

Neni 6 **Institucionet e varësisë**

(Shtuar pikat 1/1-1/4, shtuar shkronja “dh” në pikën 3, shtuar pika 4 me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Institucionet e varësisë mund krijohen për të kryer ato funksione administrative, të përcaktuara, brenda fushës së përgjegjësisë së përgjithshme shtetërore, kryerja e të cilave kërkon shkallë të lartë specializimi në menaxhim apo drejtim, dhe kanë të bëjnë me zbatimin e drejtpërdrejtë të ligjit, ofrimin e shërbimeve publike për popullatën apo shërbimeve të brendshme për administratën shtetërore ose mbështetje e këshillim për ministrinë.

1/1. Institucioni i varësisë mbikëqyret nga ministria, fushës së përgjegjësisë shtetërore të së cilës i përkasin funksionet e institucionit (në vijim ministria përgjegjëse).

1/2. Një institucion varësie krijohet edhe në varësi të Kryeministrit nëse kryen funksione në mbështetje të kompetencave të tij, në pajtim me nenin 102 të Kushtetutës, apo funksione horizontale që nuk i përkasin fushës së veprimtarisë shtetërore të një ministrie të vetme. Institucionet në varësi të Kryeministrit nuk kryejnë funksione administrative:

a) të zbatimit të drejtpërdrejtë të ligjit, ofrimit të shërbimeve publike ose shërbimeve të brendshme për administratën shtetërore; apo

b) të zbatimit të politikave shtetërore, hartimi i të cilave është nën fushën e përgjegjësisë shtetërore të një ministrie.

1/3. Përrjashtimisht, një institucion varësie që kryen funksione sipas përcaktimit në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1/2 të këtij neni, funksionon në varësi të Kryeministrit për sa kohë funksioni përkatës përbën prioritet qeverisës sipas programit politik të Këshillit të Ministrave.

1/4. Një institucion varësie nuk krijohet:

a) për të kryer një funksion administrativ që kryhet më mirë nga një strukturë administrative e brendshme e ministrisë apo përkatësisht Kryeministrit; dhe/ose

b) nëse kryerja e funksionit kërkon një numër të vogël punonjësish.

Këshilli i Ministrave përcakton numrin minimal të punonjësve për krijimin e një institucioni varësie.

2. Përveçse kur parashikohen drejtpërdrejt nga ligji, institucionet e varësisë krijohen dhe mbyllen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës apo përkatësisht Kryeministrit, dhe kanë personalitet juridik publik.

3. Në vendimin e Këshillit të Ministrave për krijimin e një institucioni të varësisë përcaktohen, të paktën:

a) emri dhe selia;

b) misioni;

c) funksionet administrative që i delegohen;

ç) ministri përgjegjës;

d) organizimi territorial, nëse është i zbatueshëm, si dhe detyrat administrative të degëve territoriale dhe kompetencat e tyre territoriale;

dh) mënyrën dhe burimet e financimit.

4. Institucionet e varësisë financohen nga buxheti i shtetit, nga tarifat, nga të ardhura të tjera të ligjshme apo një kombinim i këtyre burimeve. Në çdo rast tarifat miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 7

Degët territoriale

(Shtuar fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Degët territoriale janë struktura administrative të një ministrie ose një institucioni të varësisë, që krijohen për të ushtruar në territorin e një ose më shumë njësive të qeverisjes vendore, detyra administrative që mund të kryhen më mirë në territor, në përputhje me parimet e këtij ligji.

2. Degët territoriale krijohen dhe mbyllen me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës përkatës.

3. Në bazë të marrëveshjes së ministrave përgjegjës dhe të autorizimit të ministrit përgjegjës për administratën publike dhënë në bazë të mendimit pozitiv të Departamentit të Administratës Publike, disa ministri dhe/apo institucione të varësisë mund të kenë degë të përbashkëta territoriale apo degët territoriale të një ministrie apo institucioni varësie mund të kryejnë detyra administrative për një ministri apo institucion tjetër varësie.

Neni 8

Njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve

(Ndryshuar pika 1, shtuar pika 4 me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve janë struktura administrative që realizojnë drejtpërdrejt për individët apo subjektet private shërbimet e përcaktuara me ligj si shërbime publike në interes të përgjithshëm për të cilat administrata shtetërore ka detyrimin ligjor t'i ofrojë apo t'i garantojë, siç janë qendrat shëndetësore, spitalet, institucionet arsimore, institucionet e përkujdesjes shoqërore, shtëpitë e kulturës, muzetë dhe të tjera që kryejnë funksione të ngjashme me to. Njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve nuk përfshijnë institucionin e varësisë apo degën territoriale që merret me administrimin dhe bashkërendimin e veprimtarive të tyre.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve krijohen dhe mbyllen me urdhër të ministrit përgjegjës përkatës, në përputhje me legjislacionin e posaçëm dhe pas konsultimit publik me përfaqësuesit e përfituesve të mundshëm të shërbimit, me qytetarët e interesuar, me njësitë e qeverisjes vendore dhe me aktorë të tjerë të interesit.

3. Veprimtaria e njësive të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve drejtohet dhe bashkërendohet drejtpërdrejt nga ministria/institucioni i varësisë apo nëpërmjet degëve të tyre përkatëse territoriale.

4. Rregullat për pranimin, zhvillimin e karrierës, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën, lirin dhe largimin nga detyra për nëpunësin e njësive të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve publike përcaktohen sipas ligjit të posaçëm. Nëse ligji i posaçëm nuk i përcakton, këto rregulla miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës. Marrëdhënia e punësimit bazohet në:

a) pranimin në detyrë në bazë të parimit të shanseve të barabarta, meritës e profesionalizmit dhe nëpërmjet procedurave konkurruese që përfshijnë të paktën një testim me shkrim;

b) zhvillimin e karrierës në bazë të parimit të meritës, profesionalizimit, vjetërsisë në punë dhe rezultateve konkrete në punë;

c) qëndrimin në detyrë në bazë të parimit të vazhdimësisë dhe qëndrueshmërisë në detyrë, bazuar në integritet, profesionalizëm dhe në vlerësimin e rezultateve në punë.

Neni 9

Administrata e prefektit

1. Administrata e prefektit është administrata që mbështet prefektin në ushtrimin e kompetencave e tij, të parashikuara me ligj.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, administrata e prefektit kryen, në cilësinë e degës territoriale, funksione të tjera administrative brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të një ministrie, që i caktohet prefektit me ligj.

Neni 10

Agjencitë autonome

(Ndryshuar me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Agjencia autonome krijohet për të kryer funksionet administrative të zbatimit të ligjit dhe politikave, që kanë të bëjnë me rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve në sektorë të caktuar të ekonomisë ose të shërbimeve me interes publik, me qëllim garantimin e funksionimit të qëndrueshëm të këtyre sektorëve, rregullimin e kushteve të aksesit, përdorimit dhe operimit të infrastrukturës së madhe publike ose të infrastrukturës esenciale nga operatorët e ndryshëm, si dhe mbrojtjen e interesit publik nëpërmjet sigurimit të respektimit të standardeve teknike, ekonomike dhe të sigurisë.

2. Agjencia autonome krijohet dhe mbyllet me ligj të posaçëm dhe gëzon personalitet juridik publik në marrëdhënie me të tretët në realizimin e funksioneve të caktuara me ligj.

3. Agjencia autonome është pjesë e sistemit ministror në fushën e përgjegjësisë shtetërore të të cilit është hartimi i politikave në fushën përkatëse. Veprimtaria e saj mbikëqyret nga ministria përkatëse (në vijim ministria përgjegjëse).

4. Agjencia autonome gëzon pavarësi të plotë funksionale në ushtrimin e kompetencave të saj rregullatore të përcaktuara me ligj.

5. Asnjë organ apo institucion nuk jep udhëzime për mënyrën dhe rezultatin e ushtrimit të kompetencave rregullatore nga agjencia autonome. Aktet e agjencisë autonome në ushtrimin e kompetencave rregullatore nuk revokohen, nuk shfuqizohen, nuk anulohen, nuk rishikohen apo nuk ndryshohen nga asnjë organ apo institucion tjetër publik. Ato kundërshtohen vetëm në gjykatën kompetente për çështjet administrative, në pajtim me ligjin.

6. Agjencia autonome bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse dhe institucionet e tjera publike. Ajo ka të drejtën dhe detyrimin të kontribuojë në hartimin e politikave në fushat e lidhura me veprimtarinë e saj nëpërmjet paraqitjes së propozimeve apo paraqitjes së vërejtjeve për politikatat e propozuara nga ministria përgjegjëse.

7. Ligji i krijimit të një agjencie autonome përmban të paktën:

- a) emrin dhe selinë;
- b) misionin;
- c) funksionet dhe kompetencat rregullatore, si dhe instrumentet konkrete për ushtrimin e tyre;
- ç) organin drejtues;
- d) procedurën për përzgjedhjen, lirimin, shkarkimin, vlerësimin, shkeljet dhe masat disiplinore të organit drejtues;
- dh) mënyrën dhe burimet e financimit;
- e) ministrinë përgjegjëse.

Neni 10/1

Krijimi, bashkimi, ndryshimet dhe mbyllja e institucioneve dhe agjencie

(Shtuar me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Çdo nismë për krijimin, bashkimin, ndryshimin në çdo formë apo mbylljen e një institucioni varësie apo agjencie autonome fillon vetëm pas kryerjes nga ministria nismëtare të një analize të thelluar organizativo-funksionale.

2. Analiza organizativo-funksionale përfshin të paktën këto elemente:

- a) specifikimin e funksioneve shtetërore dhe arsytet thelbësore për propozimin e ndryshimit, si dhe arsyetimin për krijimin, bashkimin apo mbylljen e institucionit/ve ose agjencisë/ve;
- b) analizën e performancës së formës aktuale institucionale për kryerjen e funksionit që tregon domosdoshmërinë e ndryshimit, mosefektivitetin dhe mosefikasitetin e organizimit aktual;
- c) analizën e formave institucionale të mundshme për ushtrimin e funksioneve përkatëse, që çon në përzgjedhjen e llojit të propozuar të organizimit dhe përshkrimin e detajuar të tij (në vijim analiza e opsioneve për kryerjen e funksionit);
- ç) analizën për formën e organit drejtues të agjencisë autonome.

3. Analiza e opsioneve për kryerjen e funksionit, sipas shkronjës “c”, të pikës 2 të këtij neni, përfshin të paktën këto elemente:

a) analizat e formës më të mirë institucionale për realizimin e funksionit nga tipologjitë institucionale sipas këtij ligji, informacion mbi praktikatat dhe standardet ndërkombëtare për strukturën organizative për kryerjen e funksioneve të ngjashme, si dhe arsyetimin pse forma e zgjedhur është më e mira;

b) alternativat ndaj krijimit të një institucioni apo agjencie të re, rreziqet dhe sfidat shoqëruese, si dhe në mënyrë të veçantë, në rast të propozimit të krijimit të një institucioni apo agjencie të re,

justifikimin e nevojës për zgjerim të mëtejshëm të aparatit administrativ dhe shpjegimin pse funksionet përkatëse nuk mund të kryhen në mënyrë efektive nga një strukturë e brendshme e ministrisë, një institucion apo agjenci ekzistuese;

c) përputhshmërinë me rregullat e organizimit të parashikuara nga ky ligj dhe justifikimin e detajuar të përjashtimeve;

ç) pasojat e ndryshimit, përfshirë ato buxhetore, numrin e punonjësve etj.

4. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat për përmbajtjen e detajuar, formën dhe procedurën e shqyrtimit paraprak të raportit të analizës organizativo-funksionale dhe vendimmarrjen për vazhdimësinë e saj. Departamenti i Administratës Publike jep mendim në çdo fazë të procedurës së shqyrtimit dhe miratimit.

KREU III ORGANIZIMI I BRENDSHËM I INSTITUCIONEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Seksioni 1 **Ministritë**

Neni 11

Struktura e ministrisë

(Shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Ministria drejtohet nga ministri, i cili drejton politikën shtetërore për fushën që mbulon punën administrative dhe kontrolluese në institucion. Ministria organizohet në këto struktura organizative hierarkike:

- a) sekretari i përgjithshëm;
- b) drejtoritë e përgjithshme;
- c) drejtoritë;
- ç) sektorët.

Departamentet janë struktura organizative të veçanta, të cilat mbulojnë një funksion të rëndësishëm vetëm të politikëbërjes dhe krijohen në rastet kur përmenden në një ligj të veçantë.

2. Shfuqizuar.

3. Zëvendësministri zëvendëson ministrin, sipas Kodit të Procedurave Administrative. Ata janë pjesë e hierarkisë administrative vetëm kur zëvendësojnë ministrin.

4. Struktura e kabinetit mbështet drejtpërdrejt ministrin në ndjekjen e politikave përkatëse, realizimin e objektivave, si dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. Kabineti nuk është pjesë e strukturës hierarkike të ministrisë. Funkionarët e kabinetit nuk ushtrojnë asnjë kompetencë drejtuese ose administrative mbi stafin ministror.

5. Njësitë administrative të parashikuara në pikën 1 të këtij neni organizohen në madhësi të përshtatshme, në bazë të kompleksitetit të detyrave përkatëse. Si rregull, çdo nëpunës civil apo punonjës administrativ është pjesë e një njësie administrative.

6. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, ky nen zbatohet edhe për organizimin e Kryeministrisë.

Neni 12

Sektorët

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Sektori është struktura administrative më e ulët e organizimit të brendshëm të aparatit të ministrisë dhe është ekskluzivisht përgjegjës për detyrat që i caktohen shprehimisht, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrisë përkatëse.

2. Sektori drejtohet nga përgjegjësi i sektorit, i cili i raporton drejtpërdrejt drejtorit të drejtorisë, pjesë e së cilës është sektori. Përgjegjësi i sektorit, në rast mungese apo paafësie afatshkurtër, zëvendësohet nga një nëpunës civil i nivelit më të lartë i të njëjtit sektor që caktohet nga eprori i drejtpërdrejtë.

Neni 13

Drejtoritë

(Shfuqizuar fjalë në pikën 1, shtuar pikat 3/1-3/4 me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Drejtoria është grupimi i disa sektorëve me detyra të ndërlidhura. Drejtoria është niveli i dytë në strukturën organizative të ministrisë.

3/1. Drejtoria, në rast se nuk është pjesë e një drejtorie të përgjithshme apo departamenti, është njësia përgjegjëse për përgatitjen dhe vendimmarrjen në ministri brenda fushës së saj të përgjegjësisë. Drejtori i drejtorisë, për shkak të ligjit, është përgjegjës për vendimmarrjen e çdo lloji në fushën e përgjegjësisë së drejtorisë, përveç asaj që i është caktuar shprehimisht sipas legjislacionit, nëpunësve civilë të niveleve më të larta apo vetë ministrit.

3/2. Përjashtimisht, ministri apo sekretari i Përgjithshëm mund të ushtrojë drejtpërdrejt një lloj vendimmarrjeje të caktuar.

3/3. Fusha e përgjegjësisë së drejtorisë, sipas pikës 3/1 të këtij neni, dhe rastet e vendimmarrjes së drejtpërdrejtë, sipas pikës 3/2 të këtij neni, përcaktohen në rregulloren e institucionit.

3/4. Në rast të sektorëve të veçantë, që nuk janë pjesë e një drejtorie apo një drejtorie të përgjithshme, pikat 3/1 deri në 3/3 të këtij neni zbatohen me ndryshimet përkatëse për sektorin dhe përkatësisht përgjegjësin e sektorit.

2. Drejtoria drejtohet nga drejtori. Përveç kur parashikohet sipas ligjit, drejtori i raporton drejtorit të përgjithshëm ose drejtorit të departamentit, pjesë e të cilit është drejtoria.

3. Drejtori është përgjegjës për përcaktimin e objektivave të drejtorisë, nëse ato nuk përcaktohen nga një nivel më i lartë hierarkik, për planifikimin e veprimtarisë së drejtorisë dhe realizimin e detyrave të saj, duke dhënë orientime dhe udhëzime, si dhe duke monitoruar veprimtarinë e njësive administrative dhe personelit brenda drejtorisë.

4. Pika 2 e nenit 12 të këtij ligji zbatohet, me ndryshimet përkatëse, për zëvendësimin e drejtorit.

Neni 14

Drejtoritë e përgjithshme dhe departamentet

(Shtuar pikat 3/1-3/3 me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Drejtoritë me funksione të ndërlidhura grupohen në një drejtori të përgjithshme.

Drejtoria e përgjithshme drejtohet nga drejtori i përgjithshëm që i raporton sekretarit të përgjithshëm të ministrisë.

2. Përgjithshëm, me vendim të Këshillit të Ministrave, dy ose më shumë drejtori mund të grupohen në një departament. Departamenti drejtohet nga drejtori i departamentit, i cili i raporton drejtpërdrejt ministrit.

3. Drejtori i përgjithshëm dhe drejtori i departamentit janë përgjegjës për përcaktimin e objektivave të drejtorive përbërëse, përcaktimin e detyrave të drejtorive përbërëse, për monitorimin e veprimtarisë të tyre dhe për sigurimin e koordinimit ndërmjet tyre dhe me njësi të tjera të ministrisë.

3/1. Drejtoria e përgjithshme apo departamenti është njësia përgjegjëse për përgatitjen dhe vendimmarrjen në ministri brenda fushës së tij të përgjegjësisë. Drejtori i drejtorisë së përgjithshme/departamentit është, për shkak të ligjit, përgjegjës për vendimmarrjen e çdo lloji në fushën e përgjegjësisë së drejtorisë së përgjithshme/departamentit, përveç asaj që i është caktuar shprehimisht sipas legjislacionit, nëpunësve civilë të niveleve më të larta apo vetë ministrit.

3/2. Përgjithshëm, ministri apo sekretari i Përgjithshëm mund ushtrojë drejtpërdrejt një lloj vendimmarrjeje të caktuar.

3/3. Fusha e përgjegjësisë së drejtorisë së përgjithshme/departamentit, sipas pikës 3/1 të këtij neni, dhe rastet e vendimmarrjes së drejtpërdrejtë, sipas pikës 3/2 të këtij neni, përcaktohen në rregulloren e institucionit.

4. Pika 2 e nenit 12 të këtij ligji zbatohet, me ndryshimet përkatëse, për zëvendësimin e drejtorit të përgjithshëm dhe drejtorit të departamentit.

Neni 14/1

Drejtoritë apo drejtoritë e përgjithshme me status të veçantë

(Shtuar me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Një drejtori apo drejtori e përgjithshme, që kryen funksione administrative, mund të gëzojë pavarësi të shtuar funksionale, me autorizimin shprehimisht të ministrit:

- a) kur funksionet nuk kanë të bëjnë me hartimin e drejtpërdrejtë të politikave;
- b) kur parimet e përcaktuara në pikën 6, të nenit 3 të këtij ligji, përmbushen më mirë nga drejtoritë apo drejtoritë e përgjithshme, me status të veçantë;
- c) në raste të tjera të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas pikës 4 të këtij neni.

2. Pavarësia e shtuar funksionale, sipas pikës 1 të këtij neni, nënkupton:

- a) pavarësinë në kryerjen e detyrave funksionale për të cilat është krijuar;
- b) menaxhimin e buxhetit deri në një shumë të caktuar dhe administrimin e pasurisë, me autorizimin e ministrit, funksionalitet që kryhet në përputhje të plotë me legjislacionin e menaxhimit të kontrollit të brendshëm financiar dhe menaxhimit të sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

3. Drejtoria apo drejtoria e përgjithshme në këtë rast përgjigjet dhe mbikëqyr drejtpërdrejt nga sekretari i Përgjithshëm. Nenet 22 deri 23/1 të këtij ligji për mbikëqyrjen dhe llogaridhënien zbatohen me ndryshimet përkatëse.

4. Këshilli i Ministrave miraton rregulla të detajuara për krijimin, organizimin dhe funksionimin e drejtorive apo drejtorive të përgjithshme me status të veçantë, si pjesë e rregullave për organizimin e brendshëm të institucioneve.

Neni 15
Sekretari i Përgjithshëm
(Ndryshuar me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil në ministri. Sekretari i Përgjithshëm ushtron përgjegjësitë e tij në përputhje me drejtimin e përgjithshëm të politikave nga ministri, i raporton dhe i përgjigjet atij.

2. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për drejtimin administrativ të të gjithë veprimtarisë së sistemit ministror dhe ushtron çdo përgjegjësi dhe kompetencë drejtimi dhe përfaqësimi në nivel administrativ të ministrisë me përjashtim të atyre që i janë caktuar shprehimisht me akte ligjore apo nënligjore vetëm ministrit. Në veçanti ai ka këto përgjegjësi kryesore:

- a) të mbështesë ministrin;
- b) të sigurojë zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të politikave;
- c) të sigurojë drejtimin, mbikëqyrjen dhe koordinimin e sistemit të ministrisë;
- ç) të sigurojë bashkëpunimin me ministrinë e tjera dhe institucionet e organet e pavarura;
- d) të organizojë sistemin e menaxhimit dhe kontrollit financiar të ministrisë, si dhe të sigurojë administrim efektiv dhe eficient të burimeve financiare, materiale dhe njerëzore të sistemit ministror, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- dh) të realizojë drejtimin dhe udhëzimin e veprimtarisë së të gjitha strukturave administrative të ministrisë;
- e) çdo përgjegjësi tjetër që i caktohet nga legjislacioni.

3. Sekretari i Përgjithshëm në realizimin e përgjegjësiave të tij mbështetet nga strukturat përgjegjëse për funksionet horizontale.

4. Sekretari i Përgjithshëm, në rast mungese apo paaftësie afatshkurtër, zëvendësohet nga njëri prej drejtorëve të përgjithshëm të ministrisë, i cili caktohet me urdhër të ministrit.

Neni 16
Strukturat përgjegjëse për funksionet horizontale
(Shtuar togfjalësh në pikën 1 me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Menaxhimi i burimeve njerëzore, çështjet juridike të natyrës mbështetëse, mirëmbajtja dhe shërbimet e tjera mbështetëse kryhen të gjitha së bashku nga një strukturë administrative, në vijim “shërbimet e brendshme mbështetëse”, që i raporton drejtpërdrejt sekretarit të përgjithshëm.

2. Funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar, më poshtë “funksionet e financave”, kryhen të gjitha së bashku nga një strukturë administrative, që i raporton drejtpërdrejt sekretarit të përgjithshëm.

3. Funksionet e auditimit të brendshëm kryhen nga një strukturë administrative që i raporton drejtpërdrejt titullarit.

4. Njësitë e parashikuara në pikat 1, 2 e 3 të këtij neni organizohen në sektorë, drejtori apo drejtori të përgjithshme, në varësi të madhësisë dhe kompleksitetit të detyrave përkatëse.

5. Për kryerjen e detyrave të përkohshme, komplekse, që kërkojnë një qasje ndërsektoriale, mund të krijohen grupe pune të përbëra nga nëpunës civilë të ministrisë dhe institucioneve të varësisë. Ato mund të përfshijnë edhe ekspertë të jashtëm. Grupet e punës krijohen me urdhër të ministrit apo të sekretarit të përgjithshëm. Nëse nuk parashikohet ndryshe në urdhrin përkatës të

krijimit, grupi i punës kryesohet nga anëtari që ka nivelin më të lartë të nëpunësit civil. Shpërblimi i ekspertëve të jashtëm rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe specifikohet në urdhrin që krijon grupin e punës.

Neni 16/1

(Shtuar me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

Në rastet e caktimit të një nëpunësi për zëvendësimin e një nëpunësi tjetër në rastin e mungesës apo vakancës së pozicionit për një periudhë më të gjatë se 1 muaj deri në 1 vit, nëpunësi zëvendësues përfiton përgjatë kohëzgjatjes së zëvendësimit pagën më të lartë ndërmjet pagës që përfiton sipas pozicionit ku është i emëruar dhe pagës së pozicionit të nëpunësit që zëvendëson.

Neni 17

Kabinetet

(Shfuqizuar fjalia e dytë e pikës 1, shtuar pikat 3-8 me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Kabineti i ministrit mund të ketë një drejtor, këshilltarët dhe sekretarët.
2. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e kabineteve miratohen nga Këshilli i Ministrave. Struktura dhe organika e kabinetit miratohen si pjesë e organizimit të brendshëm të ministrisë.
3. Marrëdhënia e punës së funksionarit të kabinetit është marrëdhënie besimi me ministrin, të cilit i shërben. Punëdhënës në këtë marrëdhënie pune është shteti i përfaqësuar nëpërmjet ministrit.
4. Funksionari i kabinetit përzgjidhet dhe emërohet në detyrë nga ministri. Akti i emërimit nënshkruhet nga ministri dhe drejtuesi i njësisë së burimeve njerëzore të institucionit përkatës.
5. Funksionari i kabinetit lirohet nga detyra, lirisht, nga ministri. Lirimi bëhet me një afat njoftimi jo më pak se 30 ditë, pavarësisht nga sa ka zgjatur marrëdhënia e punësimit.
6. Përveç sa përcaktohet në pikën 5 të këtij neni, funksionari i kabinetit lirohet apo shkarkohet nga detyra, për shkak të ligjit, në këto raste:
 - a) me lirim nga detyra të ministrit, me përjashtim të rasteve kur ministri pasues vendos vijimin e marrëdhënies së punësimit;
 - b) me dhënien e dorëheqjes;
 - c) me dënimin me vendim të formës të prerë për kryerjen e një vepre penale; apo
 - ç) me humbjen e aftësisë për të vepruar me vendim gjykatë të formës së prerë;
 - d) me deklarinimin i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor, sipas ligjit;
 - dh) me ushtrimin e së drejtës për pensionin e reduktuar të pleqërisë, sipas ligjit;
 - e) me gjendjen në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit, të deklaruar nga vetë funksionari dhe sipas ligjit nuk merr masat e parashikuara për shmangien e konfliktit të interesit brenda afatit të përcaktuar.
7. Konstatimi i lirimit, sipas pikës 6 të këtij neni, dhe akti përkatës i lirimit apo shkarkimit bëhet nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit përkatës menjëherë me verifikimin e shkakut.
8. Pikat 1 deri në 6 të këtij neni zbatohen me ndryshimet përkatëse edhe për funksionarin e kabinetit të Kryeministrit dhe të ministrit të shtetit për aq sa nuk bie në kundërshtim me ligjin për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave.

Institucionet e varësisë

Neni 18

Organizimi i brendshëm i institucioneve të varësisë (Hequr fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Institucioni i varësisë organizohet si drejtori apo drejtori e përgjithshme, në bazë të madhësisë dhe kompleksitetit të veprimtarisë përkatëse. Niveli i organizimit përcaktohet në vendimin e krijimit.

2. Institucioni i varësisë drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori apo përkatësisht drejtori i përgjithshëm. Në rastet e institucioneve të mëdha dhe me veprimtari shumë komplekse, në vendimin e krijimit të institucionit mund të përcaktohet që drejtori i përgjithshëm apo drejtori të mbështetet nga 1 deri në 2 zëvendësdrejtorë.

3. Rregullat për organizimin e brendshëm të ministrive, sipas këtij ligji, zbatohen për organizimin e brendshëm të institucioneve të varësisë, në përputhje me nivelin e organizimit, përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Shërbimet e brendshme mbështetëse, funksionet e menaxhimit financiar dhe të auditit të brendshëm në institucionet e varësisë me një numër të vogël punonjësish kryhen nga struktura përgjegjëse administrative e ministrisë përgjegjëse.

5. Në rastin e institucioneve të varësisë të mëdha dhe me veprimtari komplekse, strukturat administrative, që kryejnë shërbimet e brendshme mbështetëse, funksionet e menaxhimit financiar, si dhe auditimin e brendshëm, krijohen brenda institucionit dhe i raportojnë drejtpërdrejt drejtorit apo përkatësisht drejtorit të përgjithshëm të institucionit.

6. Drejtuesi i institucionit të varësisë mund të krijojë, sipas nevojës, grupe pune. Pika 5 e nenit 16 të këtij ligji zbatohet edhe në këtë rast, me ndryshimet përkatëse.

7. Përveçse kur parashikohet shprehimisht, ndryshe nga ligji i posaçëm, rregullat e parashikuara nga ky nen zbatohen edhe për administratën e prefektit.

Neni 18/1

Përgjegjësitë e titullarit të institucionit të varësisë (Shtuar me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Titullari i një institucioni varësie në veçanti është përgjegjës, për:

- a) propozimin e planit të raportit vjetor të performancës së institucionit;
- b) menaxhimin e përgjithshëm dhe organizimin e sistemit të menaxhimit e të kontrollit financiar të institucionit;

c) çdo përgjegjësi tjetër që i caktohet shprehimisht me ligj.

2. Drejtorja është njësia përgjegjëse për vendimmarrjen në institucionin e varësisë. Drejtori i drejtorisë është, për shkak të ligjit, përgjegjës për vendimmarrjen e çdo lloji në fushën e përgjegjësisë së drejtorisë, përveç asaj që i është caktuar shprehimisht sipas legjislacionit titullarit të institucionit. Në rast të sektorëve të veçantë, që nuk janë pjesë e një drejtorie, përgjegjësinë për vendimmarrjen e ka përgjegjësi i sektorit.

3. Përfundimisht, titullari i institucionit mund të ushtrojë drejtpërdrejt një lloj vendimmarrjeje të caktuar.

4. Fusha e përgjegjësisë së drejtorisë, sipas pikës 2 të këtij neni, dhe rastet e vendimmarrjes së drejtpërdrejtë, sipas pikës 3 të këtij neni, përcaktohen në rregulloren e institucionit.

5. Ligji i posaçëm apo akti i krijimit mund të përcaktojë kufizime të drejtave të institucionit, në veçanti:

a) vlerën maksimale të kontratave dhe pagesave që lidhen apo miratohen pa miratimin paraprak nga ministria përgjegjëse; apo

b) kufizime të tjera për kalimin e fondeve ndërmjet ndarjeve buxhetore pa miratimin paraprak nga ministria përgjegjëse.

6. Titullari i institucionit të varësisë, në rast mungese ose paaftësie afatshkurtër, zëvendësohet nga një nga nëpunësit e shkallës hierarkike menjëherë më të ulët, të caktuar me urdhër të sekretarit të Përgjithshëm.

Seksioni 3 **Degët territoriale**

Neni 19 **Organizimi i brendshëm i degëve territoriale**

1. Në varësi të madhësisë dhe kompleksitetit të veprimtarisë, në vendimin e krijimit të tyre përcaktohet se degët territoriale të ministrive ose të institucioneve të varësisë organizohen si sektorë apo drejtori.

2. Drejtuesi i degës territoriale drejton degën përkatëse territoriale dhe i raporton e i jep llogari drejtpërdrejt sekretarit të përgjithshëm të ministrisë në rastin e degëve të tyre apo përkatësisht drejtuesit të institucionit të varësisë.

3. Sekretari i përgjithshëm ose drejtuesi i institucionit të varësisë mund të caktojë një linjë të ndryshme të raportimit dhe të llogaridhënies së një strukture administrative brenda aparatit të ministrisë apo përkatësisht institucionit të varësisë.

4. Shërbimet e brendshme mbështetëse, funksionet e menaxhimit financiar dhe ato të auditimit të brendshëm për degët territoriale kryhen nga strukturat përgjegjëse administrative të ministrisë ose institucionit të varësisë, pjesë e së cilës është dega.

Seksioni 4 **Agjencitë autonome**

Neni 20 **Drejtimi i agjencisë autonome** *(Ndryshuar me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)*

1. Agjencia autonome drejtohet nga një organ drejtues monokratik ose kolegjal.

2. Organi drejtues i agjencisë autonome është përgjegjës, për:

a) marrjen e vendimeve me karakter rregullator në kompetencën e agjencisë autonome;

b) hartimin e planit e të raportit vjetor të performancës së agjencisë, në pajtim me nenin 23 të këtij ligji;

c) çdo përgjegjësi tjetër që i caktohet nga legjislacioni.

3. Organi drejtues i agjencisë autonome është, gjithashtu, përgjegjës për drejtimin administrativ dhe administrimin e brendshëm të agjencisë. Në rastin e agjencive autonome të drejtuara nga një organ drejtues kolegjal, ligji që krijon agjencinë mund të parashikojë që drejtimi administrativ të jetë përgjegjësi e kryetarit të emëruar, një zëvendëskryetari të zgjedhur për këtë qëllim apo një nëpunësi civil të kategorisë “drejtor i përgjithshëm” apo “drejtor”, në përputhje me organizimin e agjencisë, sipas pikës 1, të nenit 20/1 të këtij ligji.

4. Zëvendëskryetari, sipas pikës 3 të këtij neni, zgjidhet nga vetë organi kolegjal ndërmjet anëtarëve të tij. Nëpunësi civil, sipas pikës 3 të këtij neni, emërohet nga organi kolegjal në përputhje me dispozitat e ligjit për nëpunësin civil.

5. Pika 2, e nenit 18/1 të këtij ligji zbatohet me ndryshimet përkatëse edhe për agjencinë autonome, me përjashtim të vendimmarrjes me natyrë rregullatore. Përjashtimisht, drejtuesi administrativ, sipas pikës 3 të këtij neni, mund të vendosë me akt administrativ të mbajë dhe të ushtrojë drejtpërdrejt një lloj vendimmarrjeje të caktuar.

Neni 20/1

Organizimi i brendshëm i agjencive autonome

(Shtuar me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Administrata e agjencisë autonome organizohet si drejtori apo drejtori e përgjithshme në bazë të madhësisë dhe kompleksitetit të veprimtarisë përkatëse. Niveli i organizimit përcaktohet në ligjin e krijimit.

2. Rregullat për organizimin e brendshëm të ministrave sipas këtij ligji zbatohen me ndryshimet përkatëse edhe për organizimin e brendshëm të agjencive autonome, në përputhje me nivelin e organizimit, përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Organi drejtues i agjencisë autonome krijon, sipas nevojës, grupe pune. Pika 5, e nenit 16 të këtij ligji, zbatohet edhe në këtë rast me ndryshimet përkatëse.

Neni 20/2

Emërimi dhe mbarimi i parakohshëm i mandatit

(Shtuar me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Kryetari dhe anëtari i organit kolegjal drejtues apo drejtuesi i agjencisë autonome (të gjithë së bashku në vijim “zyrtari drejtues”) emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës. Përjashtimisht, në pajtim me ligjin e posaçëm, zyrtari drejtues mund të emërohet dhe të lirohet nga detyra nga Kuvendi kryesisht apo me propozim të Këshillit të Ministrave.

2. Në çdo rast, zyrtari drejtues që emërohet përzgjidhet në bazë të një procedure konkurrimi të hapur e transparente, bazuar në integritetin dhe meritat profesionale të kandidatit. Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, sipas ligjit për nëpunësin civil dhe kërkesat e posaçme të parashikuara në ligjin e posaçëm që krijon agjencinë.

3. Detyra e zyrtarit drejtues është e papajtueshme me çdo detyrë tjetër në institucionin që ushtron mbikëqyrjen mbi agjencinë.

4. Zyrtari drejtues i një agjencie autonome emërohet në detyrë për një mandat 5-vjeçar, me mundësi riemërimi një herë të vetme të njëpasnjëshme.

5. Zyrtari drejtues i një agjencie autonome shkarkohet nga detyra, në rast se:

a) vepron në shkelje të rëndë të ligjit, në kundërshtim me parimin e pavarësisë apo në konflikt interesi sipas legjislacionit në fuqi;

b) dënohet për kryerjen e një vepre penale me një vendim gjykate të formës së prerë;

c) agjencia nuk paraqet brenda afatit dhe pa shkaqe të justifikuara planin vjetor të performancës apo raportin vjetor të performancës, sipas nenit 23 të këtij ligji;

ç) nuk miratohet raporti vjetor i performancës për 2 vjet radhazi;

d) raste të tjera të parashikuara nga ligji i posaçëm që krijon agjencinë.

6. Zyrtari drejtues i një agjencie autonome lirohet nga detyra, nëse:

a) jep dorëheqjen;

b) kandidon për t'u zgjedhur deputet i Kuvendit të Shqipërisë;

c) kandidon për t'u zgjedhur në organet e një njësie vendore;

ç) bëhet i paaftë fizikisht apo mendërisht për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e tij për një periudhë mbi 3 muaj;

d) mungon në detyrë pa shkak për një periudhë mbi 1 muaj;

dh) i kufizohet apo i hiqet zotësia për të vepruar me vendim të formës së prerë;

e) raste të tjera të parashikuara nga ligji i posaçëm që krijon agjencinë.

7. Përpara se të lirohet apo të shkarkohet, zyrtarit drejtues të një agjencie autonome i jepet mundësia për t'u njohur me shkakun e pretenduar dhe për t'u dëgjuar nga organi kompetent për vendimin.

8. Vendimi për të liruar dhe për të shkarkuar zyrtarin drejtues të një agjencie autonome duhet të jetë i bazuar në ligj dhe të jetë i arsyetuar.

9. Zyrtari drejtues i një agjencie autonome, i shkarkuar nga detyra, nuk ka të drejtë të rizgjidhet.

10. Paga e zyrtarit drejtues të agjencive autonome përcaktohet me ligj.

Seksioni 5

Procedura e miratimit të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore

Neni 21

Miratimi i organizimit të brendshëm

1. Organizimi i brendshëm i institucioneve të administratës shtetërore përbëhet nga:

a) struktura funksionale;

b) organika e hollësishme e institucionit, që përfshin edhe klasifikimin e pozicioneve të punës, në bazë të legjislacionit të nëpunësit civil.

2. Organizimi i brendshëm i ministrive dhe institucioneve të varësisë, përfshirë edhe degët e tyre territoriale, miratohet me urdhër të Kryeministrit, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës dhe pas marrjes së mendimit të ministrit përgjegjës për financat. Departamenti i Administratës Publike harton projekt-urdhërat dhe ia dërgon për shqyrtim dhe miratim Kryeministrit.

3. Organizimi i brendshëm i njësive të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës, pas pëlqimit paraprak të ministrit përgjegjës për financat.

4. Organizimi i brendshëm i agjencive autonome miratohet nga organi i përcaktuar në ligjin për krijimin e agjencisë, pas konsultimit me ministrin përgjegjës për administratën publike dhe me Kryeministrin apo ministrin përgjegjës për mbikëqyrjen.

5. Këshilli i Ministrave:

- a) miraton rregulla të hollësishme për organizimin e brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore;
- b) bën përshkrimin e përgjithshëm të punës së secilit tip të njësive administrative të institucioneve të administratës shtetërore;
- c) miraton procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm, si dhe përmbajtjen e relacionit shoqërues të propozimit.

KREU IV MBIKËQYRJA E ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Neni 22

Parimet dhe përgjegjësia për mbikëqyrjen dhe llogaridhënien *(Ndryshuar me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)*

1. Mbikëqyrja dhe llogaridhënia është e përhershme dhe realizohet nëpërmjet dialogut të vazhdueshëm ndërmjet ministrisë dhe institucionit apo agjencisë që mbikëqyret. Mbikëqyrja dhe llogaridhënia bazohen mbi performancën në arritjen e rezultateve.

2. Mbikëqyrja e institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome është përgjegjësi e sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë dhe llogaridhënia është përgjegjësi e titullarit të institucionit të varësisë apo agjencisë autonome.

3. Sekretari i Përgjithshëm cakton paraprakisht një strukturë administrative në aparatin e ministrisë, si njësia përgjegjëse për mbikëqyrjen e çdo institucioni apo agjencie të sistemit ministror përkatës (në vijim “njësia përgjegjëse”), në përputhje me rregullat e organizimit të brendshëm. Njësia përgjegjëse është si rregull struktura e ngarkuar me hartimin e politikave që zbatohen nga institucioni i varësisë ose agjencia autonome, apo një njësi e krijuar posaçërisht për këtë qëllim. Sekretari i Përgjithshëm prezumohet të jetë njësia përgjegjëse deri në caktimin e një njësie për këtë qëllim.

4. Në rastin e një institucioni varësie të Kryeministrit, mbikëqyrja realizohet nga Kryeministria dhe pikat 1 deri në 3 të këtij neni zbatohen me ndryshimet përkatëse.

5. Titullari i institucionit të varësisë apo organi drejtues i agjencisë autonome krijon dhe administron një sistem të brendshëm të mbikëqyrjes së performancës, raportimit dhe llogaridhënies.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për administratën publike, miraton rregullat e hollësishme për sistemin e brendshëm të performancës.

Neni 23

Plani i performancës dhe llogaridhënia *(Ndryshuar me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)*

1. Çdo institucion varësie apo agjenci autonome harton dhe propozon planin vjetor të performancës për vitin e ardhshëm (në vijim “plani i performancës”).

2. Plani i performancës përfshin kuadrin logjik të objektivave që duhen arritur brenda vitit të ardhshëm, bazuar në objektivat e sistemit ministror, të përcaktuar nga ministri, sistemin e vlerësimit të realizimit të tyre, si dhe lidhjen me kuadrin strategjik dhe të politikave shtetërore në fushën përkatëse.

3. Plani i performancës diskutohet dhe miratohet me dakordësi ndërmjet institucionit apo agjencisë dhe njësisë përgjegjëse. Në rast të mungesës së dakordësisë ndërmjet institucionit të varësisë dhe njësisë përgjegjëse, plani i performancës diskutohet me ministrin dhe, në rast të mungesës së përsëritur të dakordësisë, miratohet në mënyrë të njëanshme nga ministri. Në rast të mungesës së dakordësisë ndërmjet agjencisë autonome dhe njësisë përgjegjëse, plani i performancës miratohet në mënyrë të njëanshme nga organi drejtues i agjencisë dhe ministri miraton vërejtjet e ministrisë për planin e performancës. Plani dhe vërejtjet e ministrisë në çdo rast miratohen jo më vonë se 2 javë nga miratimi i buxhetit vjetor të vitit përkatës.

4. Çdo institucion apo agjenci harton dhe i paraqet njësisë përgjegjëse raportin vjetor të performancës (në vijim “raporti i performancës”) brenda datës 31 mars të vitit pasardhës. Raporti i performancës përfshin informacion të detajuar për realizimin e planit të performancës.

5. Njësia përgjegjëse, bazuar në raportin e performancës, fillon një proces dialogu të strukturuar me institucionin apo agjencinë për rezultatet e performancës së vitit të kaluar. Dialogu përfshin vlerësimin nga njësia përgjegjëse të rezultateve të arritura. Dialogu mbi performancën përfundon brenda 30 ditëve nga paraqitja e raportit të performancës.

6. Bazuar në rezultatet e dialogut të performancës, njësia përgjegjëse përgatit deklaratën e performancës vjetore të institucionit apo agjencisë (në vijim “deklarata e performancës”), që miratohet nga sekretari i Përgjithshëm. Deklarata e performancës përfshin miratimin ose mosmiratimin e raportit të performancës, një vlerësim të performancës dhe fushat specifike në të cilat është e nevojshme të ndryshojë performanca e institucionit.

7. Plani i performancës, raporti i performancës dhe deklarata e performancës janë pjesë e programit të transparencës dhe publikohen në faqen zyrtare të internetit të ministrisë dhe të institucionit ose agjencisë përkatëse, jo më vonë se 3 ditë nga miratimi i tyre.

8. Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishme për përmbajtjen dhe procedurën për hartimin dhe miratimin e planit të performancës, observacionit, raportit të performancës dhe deklaratës së performancës, si dhe formatet e tyre.

Neni 23/1

Instrumentet e tjera të mbikëqyrjes së institucioneve dhe agjencie

(Ndryshuar me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Për ushtrimin e mbikëqyrjes së një institucioni varësie, njësia përgjegjëse ka të drejtë, gjithashtu:

- a) të kërkojë informacion dhe dokumente, lidhur me punën e institucionit;
- b) të ndërmarrë inspektive, lidhur me ligjshmërinë, efektivitetin dhe eficiencën e punës së institucionit dhe të nxjerrë urdhra të detyrueshëm për korrektimin e veprimeve, bazuar në rezultatet e inspektimit;
- c) të nxjerrë udhëzime të detyrueshme, lidhur me zbatimin e objektivave të përcaktuar në planin vjetor të performancës.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, njësia përgjegjëse, gjithashtu, ka të drejtë:

a) të urdhërojnë fillimin kryesisht të një procedimi të caktuar administrativ nga institucioni i varësisë;

b) të udhëzojnë një institucion të varësisë të pezullojë ekzekutimin e një akti administrativ të lëshuar nga ai vetë;

c) të urdhërojnë institucionin e varësisë të ndryshojë ose të revokojë një akt administrativ apo çdo akt e veprim tjetër.

3. Në rast se një institucion i varësisë nuk zbaton udhëzimet e përmendura në pikën 2 të këtij neni brenda një afati të arsyeshëm, njësia përgjegjëse për mbikëqyrjen ushtron drejtpërdrejt kompetencat e institucionit të varësisë dhe vepron në vend të tij.

4. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe me ligj, njësia përgjegjëse është, gjithashtu, “organi epror” në procedurën e ankimit administrativ dhe në procedurën e anulimit apo shfuqizimit ndaj akteve të institucionit të varësisë, sipas Kodit të Procedurës Administrative.

5. Për ushtrimin e mbikëqyrjes së një agjencie autonome, njësia përgjegjëse ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë informacion, raporte dhe dokumente lidhur me veprimtarinë e agjencisë.

KREU V

BASHKËPUNIMI DHE BASHKËRENDIMI NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE

Neni 24

Bashkëpunimi

1. Institucionet e administratës shtetërore bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe me institucionet e tjera shtetërore e me njësitë e qeverisjes vendore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Institucionet e administratës shtetërore:

a) i sigurojnë njëri-tjetrit të dhëna, informacione dhe ndihmën e nevojshme për kryerjen e funksioneve të tyre;

b) krijojnë grupe të përbashkëta pune për hartimin e strategjive, politikave, studimeve ose projekt-akteve të veçanta për administrimin e zbatimit të projekteve të Qeverisë;

c) krijojnë njësi të përbashkëta për të kryer detyra administrative, të cilat për nga natyra e tyre kërkojnë pjesëmarrjen e disa institucioneve.

3. Grupet e përbashkëta të punës ngrihen me urdhër të përbashkët të ministrave të përfshirë. Kur nuk arrihet një marrëveshje nga ministrat e përfshirë, grupet e përbashkëta të punës krijohen me urdhër të Kryeministrit. Grupet e përbashkëta të punës përbëhen nga nëpunësit civilë dhe funksionarët politikë të ministrive përkatëse. Në to mund të përfshihen edhe ekspertë të jashtëm. Në rastet kur një detyrë e veçantë ka të bëjë me dy ose më shumë ministri, grupi i punës kryesohet nga një përfaqësues i ministrisë, së cilës i përket kryesisht detyra, ministrinë e tjera duhet të bashkëpunojnë në mënyrë të rregullt.

4. Kryeministri mund të autorizojë një ministër për të administruar ose koordinuar punën e dy ose më shumë ministrive për hartimin e politikave ose për të administruar zbatimin e një projekti qeveritar që u përket fushave të përgjegjësisë shtetërore të disa ministrive.

5. Procedurat e bashkëpunimit për secilën nga format e parashikuara në pikën 2 të këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 25

Bashkërendimi dhe shkëmbimi i informacionit

1. Ministritë i dërgojnë informacion, në përputhje me legjislacionin përkatës, Presidentit dhe Kuvendit përmes Këshillit të Ministrave. Ata mund të dërgojnë informacion drejtpërsëdrejti te njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

2. Institucionet e varësisë dhe agjencitë e pavarura komunikojnë me Presidentin dhe me Kuvendin nëpërmjet ministrit përgjegjës apo përkatësisht Kryeministrit.

3. Ministritë, institucionet e tyre të varësisë dhe organet autonome dorëzojnë informacione, dokumente dhe materiale të tjera te gjykatat, në bazë të ligjit përkatës procedural.

KREU VI

DELEGIMI I FUNKSIONEVE NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE

Neni 26

Justifikimi i delegimit

1. Ministritë mund të delegojnë funksione të caktuara apo ofrimin e shërbimeve publike te njësitë e qeverisjes vendore. Ky delegim shoqërohet me transferimin e fondeve të mjaftueshme për të kryer detyrat e deleguara.

2. Detyrat e caktuara administrative, lidhur me ofrimin e shërbimeve publike, mund t'u delegohen edhe personave privatë, fitimprurës ose jofitimprurës.

3. Delegimi, sipas këtij neni, nuk përfshin transferimin e përgjegjësisë për detyrën e deleguar.

4. Një detyrë administrative mund të delegohet në qoftë se plotësohen së bashku këto kushte:

- a) realizimi i detyrës nga palët e treta justifikohet ekonomikisht;
- b) delegimi nuk dëmton cilësinë e shërbimit publik që kryhet nëpërmjet delegimit;
- c) delegimi nuk do të cenonte interesat publikë apo të drejtat e interesat e ligjshëm të personave, ndaj të cilëve ekziston detyrimi për shërbimin publik;
- ç) delegimi nuk do të cenojë kryerjen e vazhdueshme dhe efektive të shërbimit publik të deleguar;

d) autoriteti delegues ka kapacitet të mjaftueshëm për të monitoruar dhe mbikëqyrur zbatimin e detyrave të deleguara.

Neni 27

Procedura e delegimit

1. Delegimi te njësitë e qeverisjes vendore bëhet me ligj ose me marrëveshje, sipas ligjit për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

2. Delegimi te personat privatë realizohet nëpërmjet procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

3. Në aktin e delegimit përcaktohen:

- a) funksionet e deleguara;

- b) kompetencat dhe detyrat e transferuara;
- c) financimi i detyrave të deleguara;
- ç) institucioni i ngarkuar me mbikëqyrjen, si dhe objekti e instrumentet e mbikëqyrjes;
- d) kriteret e ndërprerjes dhe mekanizmat për kryerjen e detyrave të deleguara në rast të ndërprerjes së delegimit.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 28

Vlerësimi dhe modernizimi

(Shtuar pika 1/1, ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Organizimi dhe funksionimi i institucioneve të administratës shtetërore janë objekt i vlerësimit dhe reformimit të vazhdueshëm, për të siguruar përputhshmërinë me dispozitat e këtij ligji.

1/1. Departamenti i Administratës Publike është njësi e specializuar e administratës publike për zhvillimin dhe hartimin e politikave për organizimin dhe funksionimin institucional të administratës publike.

2. Çdo ministër është përgjegjës për vlerësimin e përputhshmërisë me këtë ligj dhe modernizimin e organizimit të institucioneve brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë shtetërore.

3. Ministri përgjegjës për administratën publike nëpërmjet Departamentit të Administratës Publike mbështet ministrinë, harton propozime, jep miratimin paraprak për çdo nismë të politikave, projektakt ligjor apo nënligjor që rregullon çështje të organizimit e të funksionimit të institucioneve të administratës publike, mbikëqyr zbatimin e këtij ligji, si dhe paraqet në Këshillin e Ministrave një raport për gjendjen e zbatimit të ligjit dhe rezultatet e arritura çdo dy vjet.

Neni 29

Rregulloret e brendshme

1. Këshilli i Ministrave miraton rregullore, brenda kuadrit të legjislacionit të përgjithshëm përkatës, për standardet e përbashkëta të menaxhimit në institucionet e administratës shtetërore, përfshirë menaxhimin e burimeve njerëzore, procedurat e punës dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive administrative dhe institucioneve të administratës shtetërore.

2. Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij.

3. Rregulloret e brendshme publikohen në mënyrë të përshtatshme.

Neni 30

Periudha kalimtare dhe aktet nënligjore

1. Këshilli i Ministrave miraton apo, përkatësisht, propozon, brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ndryshimet në legjislacionin ekzistues për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore, për përshtatjen e tyre me dispozitat e këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, siç kërkohet në

dispozitat përkatëse, veçanërisht në pikën 5 të nenit 16, në pikën 2 të nenit 17, në pikën 8 të nenit 20, në pikën 5 të nenit 21 dhe në pikën 5 të nenit 24 të këtij ligji.

Dispozita tranzitore

(E parashikuar me ligjin nr. 63/2026, datë 2.7.2026)

1. Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore në zbatim të ligjit, siç kërkohet në dispozitat përkatëse, veçanërisht në pikën 1/4 të nenit 6, në pikën 4 të nenit 8, në pikën 4 të nenit 10/1, në pikën 4 të nenit 14/1, në pikën 6 të nenit 22 dhe në pikën 8 të nenit 23 të ligjit.

2. Këshilli i Ministrave miraton apo përkatësisht propozon, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ndryshimet në legjislacionin ekzistues për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore, për përshtatjen e tij me dispozitat e ligjit.

3. Institucionet, pjesë e fushës së veprimit të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij miratojnë në rregulloret përkatëse ndryshimet e nevojshme për zbatimin e përcaktimeve mbi fushat e përgjegjësisë së drejtorisë së përgjithshme/departamentit, drejtorisë apo sektorit dhe çështjet e vendimmarrjes së drejtpërdrejtë.

Neni 31

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 27.9.2012

**Shpallur me dekretin nr.7791, datë 15.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**